

FYTYRAT E LUMTURA



TË FËMIJËVE

DEMOKRACIA ËSHTË ÇELËSI I LUMTURISË

ERION (11), REDON (12), ALBIJON (12), DIELLA (12), MELISA (12), ARGJENT (11), DONITA (12), ERA (11),

DRIN (11)



Demokracia është pjesë e përditshmërisë sonë. Ajo ka një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm për ne

Sot ne jemi të lumtur. Të lumtur na bën e drejta e shkollimit, e drejta e familjes, e drejta e identitetit, e drejta e lojës, etj. E këto të drejta i kemi falë demokracisë. Kjo për shkak se vendi ynë është vend demokratik. Demokracia është pjesë e jona, aq sa jemi edhe ne pjesë

sur. Kurse sot, diskriminimet e tilla nuk ndodhin sepse të gjithë jemi të barabartë. Barazia është vetëm njëra nga elementet e demokracisë, sepse demokracia si elemente të tjera ka paqen, tolerancën, respektin, solidaritetin, etj. Këto elemente na sigurojnë neve një jetë më të lumtur.



Dy format e demokracisë janë: demokracia përfaqësuese dhe ajo e drejtpërdrejtë. Ne kemi demokracinë përfaqësuese, sepse i zgjedhim përfaqësuesit tanë dhe ata marrin vendime në emrin tonë. Kurse, vendet që kanë demokraci të drejtpërdrejtë i marrin vendimet aty për aty. Demokracia ka nevojë për ne, ashtu si peshku që ka nevojë për ujë. Ne e ushqejmë atë me punën, suksesin dhe përkushtimin tonë, këtë mos e harroni.

e saj. Në të kaluarën, roli i gruas në shoqëri ka qenë më pak i theksuar. Mirëpo sot, gruaja ka një rol shumë të rëndësishëm. Ne njohim familje, në të cilat gruaja mban tërë familjen. Vlen të përmendet se Kosova ka pasur një grua Presidente. Ky është një shembull shumë i mirë i barazisë. E përmendëm këtë shembull për të treguar se sa shumë ka ndryshuar demokracia, që nga koha kur është paraqitur në Athinë, në vitin 507 para erës sonë.

Në atë kohë, të drejtë vote kishin vetëm burrat e pa-



Gazetarët demokrat të këtij artikulli

Pjesa e dytë e artikullit tonë flet për të drejtat tona si fëmijë dhe për mënyrën se si mbrohen ato

Ne si fëmijë jemi e ardhmja. Ne jemi ata të cilët kemi në dorë të gjithë të ardhmen. Prandaj, për të na edukuar neve, e për të na bërë ta kuptojmë se sa të vlefshëm jemi, duhet të mos shkelen të drejtat tona. Kjo ngaqë, kur të marrim në dorë botën e së ardhmes, ne do të tregojmë sukses.

Për të pasur botën tonë një vend më të mirë, duhet të mos shkelen të drejtat e fëmijëve. Pikërisht për të arritur këtë është miratuar Konventa e të Drejtave të Fëmijëve. Kjo Konventë u miratua në vitin 1979. Konventa i mbron të drejtat e të gjithë fëmijëve, të cilët janë nën moshën 18 vjeçare. Kjo vlen për tërë botën pa dallim racor, fetar, gjinor apo kombëtar. Jemi të lumtur që të drejtat tona mbrohen me ligj.



Fëmijët meritojnë të jenë të lumtur



Disa nga të drejtat tona si fëmijë. Dëshira jonë është që këto të drejta të respektohen nga të gjithë



Pavarësisht gjinisë, të gjithë ne jemi të barabartë



Duke shkruar rreth temës

NE DHE LIGJET E KOSOVËS

DION (12), GETUAR (11), JON (11), JETLINDA (11), MERVA (11), ALMA (11), MALVESA (11), ALTIN (11)



Ne jemi gazetarët e rinj të „Demos-ti“ dhe ju lusim të qëndroni të vëmendshëm, sepse më poshtë do t’iu tregojmë më shumë për Kuvendin dhe ligjet e Kosovës

Kuvendi është institucion shumë i rëndësishëm për shtetin e Kosovës. Kuvendi i Kosovës ka 120 deputetë, të cilët ndryshe njihen edhe si përfaqësuesit tanë. 100 prej këtyre deputetëve janë shqiptarë, kurse 10 të tjerë janë serbë e 10 të tjerë vijnë nga komunitetet e tjera jo shumicë, që jetojnë në vendin tonë. Kuvendi i Kosovës ndër të tjerash, ka tri funksione kryesore. Këto funksione janë: funksioni përfaqësues, sepse deputetët përfaqësojnë popullin; funksioni kontrollues, sepse Kuvendi e kontrollon institucionin e Qeverisë; si dhe funksioni i fundit është funksioni legjislativ, që quhet kështu sepse Kuvendi miraton ose nuk miraton ligje. Po ashtu, ndryshon ligje atëherë kur është e nevojshme.

Deputetët janë ata qytetarë të cilët përfaqësojnë popullin e tyre në lëmi të ndryshme. Deputetët vijnë në pushtet me ndihmën e votave të popullit dhe për këtë arsye janë të obliguar të na përfaqësojnë neve. Ata vijnë nga parti të ndryshme, mirëpo së bashku punojnë për të mirën e shtetit dhe popullit. Për shembull, ne diskutuam rreth ligjeve që ndërlidhen me jetën tonë. Në Kuvend miratohen ligjet për të drejtën e shkollimit dhe nëse këto ligje ndryshohen, atëherë pa dyshim se na ndryshon edhe jeta jonë. Të gjitha këto ligje, duhet

të përputhen me nenet e shkruara në një libër shumë të rëndësishëm, që quhet Kushtetuta e Kosovës. Ky libër është akti juridik më i lartë i një shteti. Në fund, porosia jonë për ju është që t’i respektoni të gjitha ligjet që dalin nga Kuvendi.



Boja jonë e mbushur me elementet e demokracisë. Vizatim i punuar nga grupi ynë



Fotoja e grupit tonë

QYTETARIA AKTIVE ËSHTË...

ADEA (11), YLLZA (12), FLORENTINA (12), VALONI (12), EDONI (11), LEARI (12), ARDENISI (12),

RINETA (11)

Që nga klasët paraprake, kemi mësuar për qytetarinë aktive. Mirëpo, sot në Punëtorinë e Demokracisë kemi vendosur që të flasim më shumë rreth të qenurit qytetarë aktiv

Kur themi fjalën shtet në mend na vie pushteti, Kuvendi, qytetarët dhe gjithçka tjetër që ka lidhje me shtetin. Thamë se njeriu në një shtet demokratik ka shumë të drejta. Një nga të drejtat e para që i përket njeriut është e drejta e votimit. Çdo qytetar ka të drejtë të votoj. Të votuarit është një mënyrë e të qenurit qytetar aktiv. Qytetaria aktive përfshin aktivitetet që bën grupi i njerëzve që të ndihmojnë vendin e tyre. Aty nuk bëjnë pjesë vetëm të rriturit, por edhe ne si fëmijë kemi mundësinë të zhvillojmë qytetarinë aktive. Ne mund t'i vetëdijësojmë qytetarët duke shpërndarë fletushka dhe duke u anëtarësuar nëpër organizata të ndryshme.

Më 22 prill 2017, për nder të Ditës së Tokës është mbajtur një organizim në Sheshin e Prishtinës „Zahir Pajaziti“ ku kemi marrë pjesë edhe ne. Qëllimi i këtij organizimi ka qenë që t'i vetëdijësojmë qytetarët për rëndësinë e Tokës dhe të një ambienti sa më të pastër. Ky vetëdijësim u mundësua nga shpërndarja e fletushkave të ndryshme, në të cilat kishte shkrime mbi Tokën si planet, por edhe rreth pastërtisë, gjelbërimit, etj. Me këtë, ne mundohemi që të vazhdojmë t'i vetëdijësojmë njerëzit edhe më shumë rreth të qenurit qytetarë aktiv. Qytetaria aktive është vet demokracia, dhe ne jemi pjesë e demokracisë.



E drejta për të zgjedhur është një ndër të drejtat më themelore që të gjithë qytetarët e gëzojnë në demokraci



Ne jemi demokracia. Prandaj, për t'u zhvilluar demokracia ne të gjithë duhet të japim kontributin tonë



Kjo ishte tema e artikullit tonë



Gazetarët e rinjë

PROCESI I VOTIMIT

ARLINDI (12), ANISA (11) OLTİ (12), ALBINA (12), ZELLI (12), SIBORA (11), FLORENTI (12), JETMIRI (12),
FION (11)



Për të kuptuar se si zgjedhet një përfaqësues në Kosovë, lexoni më poshtë artikullin tonë



Partitë për të cilat mund të votojmë

Neve si qytetarë, të cilët jetojmë në një shtet demokratik, na ofrohen shumë të drejta. Përmes të drejtave tona, në rast se ne kemi shumë kërkesa, ato mund të plotësohen me korrektësi nga disa persona. Këta persona zgjedhen nga votat e qytetarëve. Në fillim, organizohen fushata, ku kandidatët japin premtime për kërkesat ose nevojat e qytetarëve.

Ne në Kosovë kemi dy lloje zgjedhjesh: zgjedhjet lokale dhe qendrore. Në zgjedhjet lokale, ne si qytetarë votojmë për kryetarët e komunave përkatëse. Në zgjedhjet lokale që ndryshe njihen si komunale, ne po ashtu votojmë për asambleistët. Ndërsa, në zgjed-

hjet qendrore votohen dhe zgjedhen kandidatët për deputetë, kuptohet nga votat tona. Procesi zgjedhor, me rregull duhet të ndodh çdo katër vjet. Edhe pse ne ende nuk e kemi pasur rastin të votojmë për përfaqësuesit e shtetit, në përditshmërinë tonë ne bëjmë zgjedhje të ndryshme. Ja një rast ku ne si nxënës të „Shkollës së Gjelbër“ kemi bërë një zgjedhje në formë kolektive. Zakonisht ne kemi 11 lëndë mësimore, por neve na u është dhënë rasti që të zgjedhim një lëndë, e cila do ta zgjeronte diapazonin e njohurive tona. E kjo lëndë është lënda shëndetësore, prej së cilës do të mësojmë më shumë për ndihmën e parë, për higjienën, e për shumë gjëra të tjera që lidhen me shëndetin tonë. Kjo është e tëra që ne kemi përgatitur sot për këtë artikull. Faleminderit që e lexuat.



Autorët e artikullit

PËRFAQËSUESIT E KOSOVËS

Vendimi më i rëndësishëm në një shtet demokratik është përzgjedhja e përfaqësuesve të shtetit

Kosova është shtet demokratik, që nga 17 shkurti i vitit 2008. Siç e dijme, në demokraci ekzistojnë përfaqësuesit e popullit, të cilët na përfaqësojnë në Kuvend që ndryshe quhet edhe Parlament. Këta përfaqësues njihen si deputetë dhe zgjedhen çdo 4 vjet. Zgjedhja bëhet nga vota e lirë e qytetarëve.

Deputetët kanë një rol shumë të rëndësishëm në jetën e secilit qytetar. Kjo sepse, ata miratojnë ligjet të cilat duhen respektuar nga të gjithë ne. Ligjet miratohen për të mirën tonë. Mirëpo, që një qytetar ta fitojë titullin e deputetit, ai duhet të përmbush disa kriterë. Përmendim disa nga këto kriterë: kandidati duhet të jetë premtues, t'i evitohet mangësitë e shtetit, të jetë korrekt, t'i dëgjoj ankesat e qytetarëve si dhe t'i përfaqësoj interesat e qytetarëve, etj.

Puna e deputetit nuk është e lehtë, sepse ajo ka shumë

përgjegjësi. Nuk duhet harruar se puna e tij është një faktor i rëndësishëm në ndërtimin e shtetit.

Gjatë zgjedhjes së kryesisë tonë në klasë, ne bazohemi në vetitë pozitive të nxënësit si: të evitohet problemet në klasë, të jetë i sjellshëm dhe korrekt, të jetë përgjegjës për obligimet e tij dhe të di të menaxhoj situatat e pakëndëshme në klasë. Në këtë formë zgjedhen edhe deputetët, që gjatë mandatit të tyre 4 vjeçar kanë një punë dhe përgjegjësi të madhe. Prandaj, nevojitet përkushtim i madh. Ne si gazetarë të vegjël deshëm që t'iu tregonim pak për rolin e deputetit. Prandaj, me shpresën që këto informata të jenë të nevojshme për ju, kjo ishte e tëra për këtë artikull. Ju mos harroni që ne si popull udhëheqim në demokraci dhe vota jonë është vendimarrëse. Bëhuni pjesë e vendimmarrjes duke marrë pjesë në zgjedhje.



Deputetët mendojnë për mirëqenien tonë



Ne i zgjedhim deputetët, kurse ata na përfaqësojnë neve



Kjo është një kuti votimi dhe ne votuam. Po ju?



Diskutimi ynë rreth temës së artikullit



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Shkolla e Gjelbër“
E-mail: info@toka-ks.org Klasa: VI-1
Website: www.toka-ks.org Vendi: Prishtinë